



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.544/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli ne Prishtinë, kundër debitorit K.S. B.I NSH. “Extreme Pizza” me seli ne Prishtinë, me NUI 811327271, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.951/23 të datës 27.11.2023, me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.951/23 të datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.951/23 të datës 27.11.2023, ka aprovuar prapësimin e debitorit K.S. B.I NSH. “Extreme Pizza” me seli ne Prishtinë dhe ka anuluar Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.210/23 i datës 01.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbartimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta ndryshoj ashtu qe urdhri përmbartimor te shfuqizohet ne tërësi ose aktvendimi i ankimuar te anulohet dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës, me seli ne Prishtinë, me datën 28.04.2023 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor – Urdhëresë për ndëshkim me gjobe mandatorë me kundërvajtje, me nr.000873 dt.08.02.2023, me te cilin vendim është detyruar debitori te përmbushë prestimin ne emër te gjobës mandatorë, per shkak te vendosjes se gjeneratorit te rrymës, ne hapësira publike, ne shumen prej 200.00 euro

Përmbaruesi privat Destan Bujupaj nga Prishtina, me urdhrin përmbarimor P.nr.210/23 i datës 01.05.2023, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori qe ne emër te masës ndëshkimore - gjobës, t'ia paguaj kreditorit shumen si ne propozim, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke theksuar se ky dokument mbi bazën e te cilit është lëshuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet ligjore te cilësohet si i tille, përkundër faktit qe siç pretendon debitori ne prapësim se një detyrim te tille e ka përmbushur menjëherë pasi i është dorëzuar, përkatësisht para inicimit te procedurës përmbarimore.

Ndaj prapësimin te debitorit, kreditori me date 22.06.2023, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se dokumenti përmbarimor i plotëson ne tërësi kushtet te cilësohet si i tille, pasi qe është ne tërësi ne pajtim me Ligjin për Kundërvajtje.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.951/23 të datës 27.11.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.210/23 i datës 01.05.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se – Urdhëresë për ndëshkim me gjobe mandatorë me kundërvajtje, me nr.000873 dt.08.02.2023, me te cilin vendim është detyruar debitori te përmbushë prestimin ne emër te gjobës mandatorë, per shkak te vendosjes se gjeneratorit te rrymës, ne hapësira publike, ne shumen prej 200.00 euro, nuk është dokument përmbarues dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu nuk është ne pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 te LPP i cili përcakton se:

“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, ndërsa një dokument përbarimor për të shërbyer si titull përbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim.

Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Urdhëresë për ndëshkim me gjobe mandatorë me kundërvajtje, me nr.000873 dt.08.02.2023, i lëshuar nga debitori nuk është dokument i përbarueshëm, pasi që vendimi nuk është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm, ashtu që si i tillë është i pavlefshëm juridikisht dhe i pa përshtatshëm për përbarim, pasi që i njëjti nuk i plotëson të gjitha kushtet ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ i cili nuk është i formës së prerë, i njëjti si i tillë nuk i plotëson kushtet për përbarim.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.544/24, me datë 05.06.2024**

**Gjyqtari
Faton Bajrami**